

MIGRIMI I SHQIPTARËVE TË PRESHEVËS PAS VITIT 1999

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË DEPARTAMENTIN E SOCIOLOGJISË

NGA

SHERMINE ILJAZI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË
PRISHTINË

QERSHOR 2021

Rezyme

“MIGRIMI I SHQIPTARËVE TË PRESHEVËS PAS VITIT 1999”

Mentori:

Dr. Prof. Sabri Kiçmari

Në punimin shkencor të Masterit kam hulumtuar “**Migrimet e shqiptarëve të Preshevës pas vitit 1999**”. Studimi në kontekstin e dinamikës së migrimëve ka për qëllim paraqitjen e të dhënave faktike të periudha kohore të migrimëve, llojet e migrimëve dhe faktorët e migrimëve. Migrimet e shqiptarëve nga komuna e Preshevës, shpërnguljet e dhunshme për në vende të ndryshme të botës kanë qenë të pranishme edhe para vitit 1999-ta por kanë vazhduar edhe pas vitit 1999 e deri më sot. Pikërisht lëvizjet e shqiptarëve ndër vite kanë ndikuar edhe në stukturën etnike. Një numër bukur i madh i shqiptarëve tashmë jetojnë dhe veprojnë nëpër vende të ndryshme të botës.

Në Komunën e Preshevës, ashtu edhe në të gjitha trojet të banuara me shqiptarë migrimet janë të pranishme dhe papunësia konsiderohet shqetësuese. Në Preshevë rreth 70% e popullatës të papunë, me një pozitë të palakmueshme e cila gjendet (nën) administratën e Sërbisë. Në punim janë paraqitur faktet e të dhënave primare të shfrytëzuara nga literatura, dhe faktet e të dhënave sekondare, intervista me persona nga profilet e fushës së migrimëve dhe anketat e realizuara me qytetarët e Preshevës. Në punim kam përdorur dy Metoda: metoda kuantitative dhe metoda kualitative, duke analizuar migrimet e ndodhura nga Komuna e Preshevës.

Në kapitullin e parë, kam paraqitur **Strukturën etnike të shqiptarëve të Preshevës** para vitëve 1999 dhe regjistrimet e shqiptarëve të Preshevës pas vitit 1999. Interpretimi i të dhënave të popullsisë nga pushtuesit e ndryshme kishin për qëllim fshehjen e numrit të popullsisë shqiptare. Qysh prej kohës së Perandorisë Osmane nuk jepen statistika të sakta për numrin e popullsisë shqiptare, por duke i regjistruar mbas fesë, duke identifikuar si mysliman, të krishter dhe ortodoks, e jo në bazë të identitetit etnik.

Po ashtu e njejta metodë vazhdon edhe në Mbretërin Jugosllave, identiteti etnik filloi të regjistrohet pas luftës së dytë botërore, më vitin 1948 jepet një pasqyrë më e qartë e numrit të popullsisë shqiptare. Ndërsa pas vitit 1999, regjistrimet e popullsisë në Luginë të Preshevës janë bërë në vitin 2002.

Në regjistrimin e popullsisë të vitit 2002 gjithsej kanë qenë 80.978 shqiptarë, mirëpo rreth 23.743 (20.8% e popullsisë së përgjithshme nuk janë përfshirë në regjistrim. Ndërsa regjistrimi i vitit 2011 është bojkotuar nga shqiptarët përshkak pozitës të palakmueshme dhe diskriminimit politik nga Serbia.

Në Kapitullin e dytë, kam elaboruar **Spastrimin etnik, metodë e ripërsëritur** nga ana e Serbisë edhe pas konfliktit të vitit 2001. Serbia i diskriminoi shqiptarët në qasje shumëdimensionale si politike, sociale, kulturore dhe arsimore. Shqiptarët këtu përjetuan luftë, përndjekje të intelektualëve, vrasje dhe valë të shpërnguljeve nga trojet e tyre. Serbia vitet e fundit ka arritur të pasivizojë qindra e mijëra adresa të shqiptarëve duke i fshirë nga regjistret civile.

Faktori politik, si indikator i parë për migrimet e shqiptarëve, shqiptarët e Preshevës edhe pas vitit 1999 nuk patën mundësin e lirisë dhe të integritit në Serbi, sepse përjetuan konfliktin, migrimet e dhunshme, dhe përndjekjet. Nuk u krijuan mekanizmat për mbrojtjen dhe sigurinë e shqiptarëve qoftë nga ndërkombëtarët por as nga Kosova dhe Shqipëria.

E drejta e Arsimimit në gjuhën shqip dhe tekstet shkollore, edukimi i brezave konsiderohet baza e zhvillimit të shoqërisë e pikërisht këtë Serbia nuk i lejoi shqiptarët duke penguar në tekstet shkollore, pra Serbia nuk ka investua fare në Shkolla apo në cilësinë e arsimit. Përkundrazi i ka kufizuar që të mos integrohen shqiptarët. Serbia e ka ende problem pranimin e diversitetit etnik dhe kulturor.

Në kapitullin e tretë, kam paraqitur **Faktorin ekonomik si shtytës për migrimet e shqiptarëve** dhe tërheqjet e investimeve, në 20 vitet e fundit Serbia nuk investoi

fare. Që nga viti 2000 me mbylljen-falimentimeve të fabrikave, migrimi filloi të rritet, pra Sërbia arriti ti tërheqë shumë investime duke pamundësu hapje të vendeve të punës. Ndërsa as Shqipëria dhe Kosova nuk invesoi financiarisht për ndaljen e migrimeve të heshtura të shqiptarëve.

Në kapitullin e katër, kam elaboruar **Migrimet e shqiptarëve të Preshevës në vende të ndryshme të Botës.** Shqiptarët e Preshevës gjatë konfliktit u shpërngulen qindra e mijëra familje. Vendet që më së shumti migruan sipas hulumtimit tim me shqiptarët e Diasporës, të anketuarit janë shprehur se më së shumti kanë migruar në Zvicërr, Gjermani, Belgjikë, Austri dhe Kosovë.

Ndërsa rreth 13,000 shqiptarë migruan për në Kosovë këtu hyn edhe migrimet e përkohshme. Shqiptarët e Preshevës u orjentuan në zonën e Gjilanit, Fushë Kosovë, Prishtinë dhe Matiçan.

Shqiptarët e Preshevës presin që dy shtetet shqiptare të ndihmojnë edhe financiarisht pasi ndihmat kanë qenë të vogla, këto ndihma kanë qenë më tepër mbështetje morale dhe vëllazërore se sa për parandalimim e migrimeve të heshtura.

Realisht rrjetizimi mes Prishtinës dhe Tiranës mungon, mandej bashkëpunimi i shqiptarëve nga të gjithë trojet nuk janë të kristalizuara, shqiptarët nuk kanë strategji politike që të reaalizohen ineteresat kombëtare të shqiptarëve as nga shteti i Shqipërisë por as nga Kosova, uniteti i shqiptarëve mungon prandaj duhet të krijohet platforma për ndërveprim dhe bashkëpunim me plane më afatgjate për zgjidhjen e shqiptarëve.

Gjithashtu unë kam realizuar **Anketa me shqiptarët e Preshevës** kryesisht me shqiptarët që jetojnë në Diasporë. Sipas të anketuarëve, periudha e migrimit që më së shumti kanë migruar kanë qenë vitet 1999-2003, përshkak konfliktit. Pastaj rritje të migrimit ka pasur prej vitit 2009 kur liberalizohen vizat nga BE-ja për Sërbinë. Dhe pas vitit 2016 shqiptarët migruan përshkak papunësisë.

Pra faktori politik dhe ekonomik kanë qenë faktorët kryesor për migrimin e shqiptarëve nga trojet e veta, ndërsa 92% janë shprehur se është shumë e nevojshme që të investohet në Preshevë për të mos ndodhur migrime drastike.

Faktikisht nuk është se kanë bërë shumë nga bashkësia lokale, as edhe ajo ndërkombëtare por as Shqipëria e as Kosova për shpopullimin që po i bëhet shqiptarëve nga Sërbia. Por edhe pozita e vështirë e shqiptatëve të Luginës asnjëherë nuk është folur në bisedime Serbi-Kosovë.

